



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 683, Datë 18.03.2020

“Mbi miratimin e Udhëzuesit “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.03.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e Udhëzimit “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike”

Baza Ligjore: Nenet 24, shkronja dh), të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar;

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE :

1. Udhëzuesi është përshtatur duke u përafuar me Direktivën e Komisionit Evropian 2002/77/ EC e 16 shtatorit 2002 “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike”.¹

¹ Commission Directive 2002/77/EC of 16 September 2002 on competition in the markets for electronic communications networks and services. Official Journal of the European Communities, 17.9.2002, L 249/21

2. Udhëzuesi synon të kontribuojë në zhvillimin e tregut në sektorin e komunikimeve elektronike, ndër të tjera duke zhvilluar një praktikë rregulluese të qëndrueshme dhe një zbatim të qëndrueshëm të kuadrit ligjor.
3. Udhëzuesi ka për qëllim që të sigurojë se çdo ndërmarrje ka të drejtën e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike ose të shtrirjes së rrjeteve të komunikimit elektronik pa pasur kufizime.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja dh), të Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar,

VENDOSI:

Miratimin e Udhëzuesit “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS